

Info

Epilepsia



Masat e ndihmës së shpejtë
te krizat epileptike

Lidhja e epilepsisë Hulumton – ndihmon – informon

KRIZAT E PËRGJITHSHME TONIKO-KLONIKE („GRAND MAL“)

Më e rëndësishmja për të gjithë familjarët ose njerëzit tjerë, të cilët vëzhgojnë një krizë „të madhe“, është që përkundër shqetësimit të vetëkuptueshëm dhe merakut, mundësisht të mos bien në panik dhe të sillen me urtësi. Kalimtarët dashamirës, por njëkohësisht dhe fort të emocionuar, mundën që përmes një ndihme të supozuar të pallogaritur mirë, sipas rrethanash, të shkaktojnë dhe dëme të tjera plotësuese. Sado kërcënuese që të duket një krizë e përgjithshme toniko-klonike për të prekurin, ajo sipas rregullit, nuk përbën rrezik për jetën. Përpos kësaj, praktikisht është e pamundshme që një krizë që tashmë ka filluar, të ndërpritet. Klithja e dalë prej të prekurit në fillim të krizës nuk është shprehje e dhimbjeve të kushtëzuara nga kriza, por bazohet në thithjen ose nxjerrjen konvulzive të ajrit përmes rrugëve të frymëmarrjes dhe fytit.

Të gjitha masat ndihmëse kanë për qëllim që të shmangen komplikimet e mundshme dhe veçanërisht lëndimet.

Po të jetë e mundur, mund të provohet që individi i goditur nga kriza të kapet para se të rrezohet ose të shtrihet, për të mbajtur hapur rrugët e frymëmarrjes dhe për një lehtësim të rrjedhjes së pështymës, sipas rrethanave edhe të vjellave, pas shuarjes së ngërçeve të vendoset më së miri në krah me këmbët e palosura sipër njëra-tjetrës (=e ashtuquajtura pozitë anësore stabile). Qysh në fillim të sulmit, tek njerëzit e moshuar mund të provohet që të mënjanohet me shpejtësi edhe proteza e dhëmbëve. Mirëpo nëse tashmë nofullat janë shtrënguar për njëra-tjetrën, në të ashtuquajturën fazë tonike, atëherë do të jetë vonë për këtë veprim. Nëse ka nevojë që trupi i të prekurit të tërhiqet prej një zone të rrezikshme ose të lëvizet, ai duhet kapur në pjesën e sipërme të trupit dhe jo në ekstremitetet. Gjatë një tërheqje për krahësh në kohën e një krize mund të vijë lehtë deri te ndonjë ndrydhje e kyçeve të shpatullave.

KRIZAT E PËRGJITHSHME TONIKO-KLONIKE („GRAND MAL“):

BËJE

Ruaj qetësinë (sidomos në publik dhe gjatë tensionit tek të pranishmit e tjerë), shiko orën (fillimi i krizës?).

Në rast shenjash të para të njohura të një krize (p.sh. paralajmërimi i të prekurit, „ngulja e syve“), ndihmo shtrirjen në divan, krevat ose në dysheme.

Provo që të mënjanojnë sendet e rrezikshme

- p.sh. mobilie të vogla ose sende të holla, të mprehta, të forta ose të nxehta
- mundësisht të goditurit t'i hiqen nga duart me kujdes sendet e rrezikshme (thika, gërsërët etj.)
- mundësisht t'i hiqen syzet

Po të jetë e mundur, i godituri të tërhiqet (të kapet për trupi, në pjesën e sipërme të trupit) nga një zonë e rrezikshme (p.sh. një zjarr i hapur ose platformë shkallësh)

Pas pushimit të ngërçeve të vendoset në „pozitë anësore stabile“; t'i mbahen rrugët e frymëmarrjes të lira dhe të pengohet rrjedhja e pështymës dhe të vjellave në rrugët e frymëmarrjes dhe në mushkëri.

Në rast se gjenden në afërsi, nën kokë t'i vendoset ndonjë send i butë (p.sh. jastëk, pulovër ose të ngjashme).

Robat të zbrërthehen, me qëllim lehtësimi të frymëmarrjes

- p.sh. të lirohet kravata
- të hapet jaka e këmishës

Në rast se paraqiten shumë kriza njëra pas tjetrës, pa mundësi që i godituri të vijë sërish për një kohë në vete, nëse shtangimi nga kriza zgjat më shumë se 3 minuta, nëse paraqiten lëndime ose komplikacione të tjera, të thirret një mjek ose ambulanca.

HIQ DORË NGA

Ankthi, paniku dhe stresi.

Prova që një fillim krize ta pengosh përmes „bindjes e qortimit“, të bërtasësh mbi të goditurin, ta tundësh, ta godasësh ose t'i ofrosh atij substanca aromatike.

Përpjekja që gjatë një krize të goditurin ta ulësh në një karrige ose ta çosh më larg. Përpjekjet që krahët dhe këmbët t'ia mbash të shtrënguar, t'ia hapësh duart e shtanguara ose që të goditurin „ta sjellësh sërish në vete“.

Përpjekjet që të goditurin ta tërheqësh për krahësh (rreziku nga dislokimi i kyçeve në supe)

Ideja që qysh gjatë shtangimit të vendoset në pozitë anësore stabile (rreziku i dislokimit të krahëve në kyçet e shpatullave).

Përpjekjet që t'i futen në gojë antiepileptikët ose medikamentet tjera (rreziku i mbetjes në fyt).

Mbajtja shtrënguar e të goditurit, gjatë e sidomos pas rënies në krizë (shton rrezikun për lëndime).

Përpjekjet që dhëmbët të mbahen të ndarë ose që të futen sende midis nofullave (rrezik nga lëndimi për dhëmbët ose për gishtërinjtë).

Që në rast epilepsish të njohura dhe të një krize të pakomplikuara të thirret gjithnjë mjeku ose ambulanca.

Mos i futni asgjë midis dhëmbësh

Shpesh do të provohet me qëllimin më të mirë që të shtangurit t'i futet mes dhëmbësh çfarëdo sendi, për shembull ndonjë lugë ose laps, për të penguar një kafshim gjuhe. Mirëpo një gjë e tillë, sipas rregullit, nuk tregon sukses dhe më parë shkakton dëme tek dhëmbët ose lëndime të tjera se sa që ndihmon. Vetëm familjarët ose specialistët, në rast se e njohin me saktësi llojin e krizës, mu në fillim të saj mund të provojnë të fusin midis dhëmbësh një material të përshtatshëm, si p.sh. ndonjë pykë të fortë speciale prej gome.

„Gaffer“-ët* të dëbohen

Pas rikthimit të vetëdijes, për të prekurin shpeshherë gjëja më e pakëndshme gjatë një krize, e cila për të nuk përfaqëson tashmë ndonjë gjë të veçantë, janë kureshtarët e ngeshëm që i qëndrojnë përçark. Nëse jeni me të prekurin në rrugë e sipër, ose jeni dëshmitar i rastit i një krize

në cilësinë e një kalimtar, të prekurin mund ta ndihmoni shumë nëse ia dilni t'i dëboni individët e padobishëm kureshtarë që qëndrojnë përreth, për shembull me vërejtjen se situatën e keni të njohur, se bëhet fjalë thjesht për një krizë dhe asgjë më shumë.

KRIZAT FOKALE ME ÇRREGULLIM VETËDIJEJE (KRIZAT FOKALE PSIKO-MOTORIKE KOMPLEKSE)

Më e rëndësishmja është, ashtu si në rastin e krizave të përgjithshme toniko-klonike, të ruhet qetësia dhe kontrolli. Të goditurit, ndonëse në dukje të çorientuar, çuditërisht lëndohen shumë rrallë, qoftë edhe sikur, p.sh. në fillim të krizës të kenë pasur në dorë një thikë. Edhe në rastet e definuara si „automatizma“, lëvizje dhe veprime që rrjedhin në mënyrë të pandërgjegjshme, çuditërisht rrallëherë ndodh ndonjë gjë.

* Shef, bos, ekspert, mjeshtër për gjithçka (ironi)

KRIZAT FOKALE ME ÇRREGULLIM VETËDIJEJE:

BËJE

Të ruhet qetësia (sidomos në vend publik dhe gjatë tensionit tek të pranishmit tjerë), të shikohet ora (fillimi i krizës?). Po të jetë e nevojshme, i prekuri të përcillet larg një zone të rrezikshme (p.sh. rruga ose shporeti).

Provo që të mënjano shendet e rrezikshme

- p.sh. mobilie të vogla ose sende të holla, të mprehta, të forta ose të nxehta
- mundësisht të goditurit t'i hiqen nga duart me kujdes sendet e rrezikshme

Qëndro pranë të goditurit, deri sa të kalojë kriza, dhe derisa ai të jetë sërish normalisht i përgjegjshëm, d.m.th. ta dijë se ku gjendet dhe ku do të shkojë.

Pas krizës të ofrosh ndihmën: p.sh. ta çosh drejt një mundësie pushimi

- p.sh. për në shtëpi
- ta pyesësh nëse do ta thërrasë dikë
- ta pyesësh nëse duhet thirrur ambulanca
- t'ia përshkruash të prekurit rrjedhën e krizës dhe kohëzgjatjen e saj
- mundësisht t'ia japësh emrin dhe adresën
- Robat të zbërthehen, me qëllim lehtësimi të frymëmarrjes
- p.sh. të lirohet kravata
- të hapet jaka e këmbës

Në rast se paraqiten shumë kriza njëra pas tjetrës, pa mundësi që i godituri të vijë sërish për një kohë në vete, nëse shtangimi nga kriza zgjat më shumë se 10 minuta, nëse paraqiten lëndime ose komplikacione të tjera, të thirret një mjek ose ambulanca.

HIQ DORË NGA

Mbajtja shtrënguar e të prekurit gjatë, dhe sidomos pas një krize.

Që të prekurin ta lësh vetëm gjatë një krize.

Që të provosh të influencosh sjelljen e të prekurit gjatë një krize.

Që të prekurin ta riaktivizosh menjëherë pas një krize.

Rrini pranë të prekurit dhe mos e lini vetëm.

Një krizë e nisur një herë nuk mund të ndalohej ose të ndërpritet. Mund të bëhen përpjekje të kujdesshme që të prekurit t'i hiqen nga duart sende të rrezikshme ose që ai të tërhiqet nga zona e rrezikshme. Në rast shprehjesh ofenduese ose lëvizjesh mbrojtëse, duhet „dorëzuar“ menjëherë, sepse përndryshe lehtë mund të vijë deri te grushtimi dhe përleshja (për të cilën i prekuri kryesisht nuk do të kujtojë asgjë më vonë!).

MUNGESAT

Mungesat kryesisht zgjasin vetëm 5 deri 30 sekonda, dhe sipas rregullit janë të parrezikshme, kështu që masat për ndihmën e shpejtë në këtë rast janë të panevojshme. Edhe praktikisht nuk vjen ndonjëherë te ndonjë lëvizje, veprim ose rrëzim lëndim-shkaktues ose te ndonjë lëvizje tjetër të ngjashme. Duke qenë se të prekurit as edhe për krizën vetjake nuk dinë gjë fare, u duhet tërhequr vërejtja më vonë se kanë përjetuar një krizë.

Epilepsia mund të prekë këdo

Së paku pesë për qind e njerëzve gjatë jetës së tyre vuajnë nga një krizë epileptike. Afro një për qind e popullsisë sëmurët nga epilepsia gjatë jetës së tyre. Në Zvicër bëhet fjalë për 70.000 persona, midis tyre 15.000 fëmijë.

Lidhja e epilepsisë – shumëfish aktive

Lidhja zvicerane e epilepsisë hulumton, ndihmon dhe informon që nga viti 1931. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i përditshmërisë dhe gjendjes së të prekurve nga epilepsia në shoqërinë zvicerane.

Hulumtimi

Ajo nxit zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në të gjitha fushat e epilepsisë.

Ndihma

Informacione dhe këshillime në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht:

- për të prekurit dhe familjarët
- për specialistët e fushave nga më të ndryshmet

Informimi

Lidhja e epilepsisë informon dhe sensibilizon opinionin publik si dhe mbështet integrimin social të individëve të prekur nga epilepsia – si për shembull përmes kësaj broshure.

Përpiluesi:

Dr. med. Günter Krämer

Kryetar i Lidhjes së epilepsisë 2001–2016
izerischen Epilepsie-Liga

Fletëpalosje të tjera në gjuhën shqipe:

Ç'është epilepsia?

Epilepsia dhe patentat e shoferit

Informacione të tjera

Në gjermanisht, frëngjisht, anglisht,
pjesërisht italisht:

Schweizerische Epilepsie Liga (Lidhja zvicerane e epilepsisë)

Seefeldstrasse 84

CH-8008 Zürich

T +41 43 488 67 77

F +41 43 488 67 78

info@epi.ch

www.epi.ch

PC 80-5415-8

Gjendja e informacioneve: 2017

Realizuar përmes ndihmës miqësore të: Desitin Pharma GmbH, Eisai Pharma AG, GlaxoSmithKline AG, Novartis Oncology, Sandoz Pharmaceuticals AG.

Sponsorët nuk kanë ndikim në përmbajtje.

Pamja e ballinës: ImagePoint/Markus Schneeberger